



Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti IV, nr. 16, tetor-dhjetor 2024

**Krishtlindja na siguron:
«Mos kini frikë!»**

faqe 3



Misioni Katolik Shqiptar
Katholische Albanische Mission

LUZERN

REVISTË INFORMATIVE, KULTURORE
DHE SHPIRTËRORE E MISIONIT KATOLIK
SHQIPTAR NË LUZERN



SELIA E REVISTËS
Rodteggstrasse 6, CH-6005 Luzern
St. Michael



Tel: +41 41 250 52 60



anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch
albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch
ukas_cr@hotmail.com



<https://www.misioni-lu.ch/>



[https://www.facebook.com/ Misioni Katolik
Shqiptar - Luzern](https://www.facebook.com/Misioni%20Katolik%20Shqiptar-%20Luzern)



TË NDIHMOJMË REVISTËN

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3
Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 |
6005 Luzern

REDAKSIA

Dr. Don Anton Uka – kryeredaktor
Motër Vida Ademi – koordinuese
Veneranda Qerimi – redaktore e teksteve
Mirlinda Dushi Berisha – përgjegjëse për
intervista
Gjane Simoni – asistente
Motër Mrika Sabedini – asistente

faqe

- 4–5** **AKTIVITETET E MISIONIT**
Shtegtarë në Fatima të Portugalisë
- 8** **AKTIVITETET E MISIONIT**
Shëtitja e Ministrantave në Europapark
- 10–11** **AKTIVITETET E MISIONIT**
Takim mes përfaqësuesve të bashkësive
fetare shqiptare në Zvicër
- 12–13** **AKTIVITETET E MISIONIT**
Shën Jeronimi dhe Shën Nënë Tereza,
dy gjigantë të qytetërimit shqiptarë
- 16–17** **AKTUALITET**
Takim mes përfaqësuesve të bashkësive fetare
shqiptare në Zvicër
- 18–19** **KRISHTLINDJA**
Testoje njohurinë tënde mbi Krishtlindjen
- 20–21** **KULTURË**
Rrënjët tona na bashkojnë
- 24–25** **KULTURË**
Mirënjohëse për emocionet që përjetova
- 27** **PËRSHPIRTËRI**
Momentet e fundit të jetës së dom Gjon Gazullit
- 28–29** **PËRSHPIRTËRI**
Die Geschichte des Heiligen Nikolaus
- 33** **PSIKOLOGJI**
Dhuna rrënjës të keqen dhe çrrënjës të mirën
- 34** **KISHA NË BOTË**
Jubileu 2025: ç'do të thotë të jesh shtegtar?

Krishtlindja na siguron: «Mos kini frikë!»

Kremtimi i ngjarjes historike të lindjes së Jezusit, siç dihet, bazohet në shkrimet e shenjta të Biblës, të cilat tregojnë dhe dëshmojnë për këtë ngjarje të veçantë dhe të pazëvendësueshme për jetën e çdo njeriu. Duke lexuar historinë e kësaj ngjarjeje, shohim se një nga fjalët e para është fjala siguruese e engjëjve drejtuar barinjve: *“Mos kini frikë! Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë: gëzim të madh për mbarë popullin! Sot, në qytet të Davidit ju lindi Shëlbuesi – Krishti Zot!”* (Lk 2, 10-11).

Fjala e engjëjli të Zotit, siç e siguroi Zakarinë, atin e Gjonit, Marinë, nënën e Jezusit, Jozefin, të fejuarën e Marisë, barinjtë e Izraelit, kështu tani ajo dëshiron të na sigurojë edhe neve duke na thënë: «Mos kini frikë!»

Frika, në përgjithësi, është një nga ato emocione që ka fuqinë të pengojë një person të jetojë dhe të ndjejë emocionin e gëzimit, duke e bërë atë të jetojë në pasiguri të vazhdueshme. Edhe sot, duke qenë se shumë njerëz jetojnë në frikë dhe ankth, ata kanë nevojë të dëgjojnë dhe të besojnë zërin qetësues dhe siguries të Zotit, të njerëzve vullnetmirë, të miqve të vërtetë, të familjes së bashkuar, të Kishës besimtare, të përvojës së vërtetë shpirtërore dhe mendore që u thotë me qartësi dhe bindje: Mos kini frikë sepse sot ka lindur për ju Shëlbuesi - Krishti Zoti.

Frika është e pranishme në jetën e njerëzve jo vetëm për shkak të problemeve, shqetësimeve, pasigurive, konflikteve të jashtme që mund të ekzistojnë. Por, unë mendoj se ajo është e pranishme në një numër të madh njerëzish, para së gjithash, për shkak të përballjes me realitetin ose me të vërtetën tonë të dhimbshme dhe mëkatore që fshihet brenda nesh, për shkak të varësisë sonë nga ato gjëra dhe nga ata njerëz që nuk mund të ofrojnë siguri afatgjatë, për arsye sepse ndoshta jetojmë keq dhe në mënyrë të papërgjegjshme me veten, me të tjerët dhe me Zotin. Kjo është frika që e pengon njeriun të marrë frymë lirshëm dhe nuk e lejon të jetojë mirë dhe në paqe me veten, kjo është frika që e pengon të jetuarit me besim dhe shpresë se gjërat dhe jeta do të shkojnë më mirë nga sa mendojmë.

Sot shumë njerëz bërtasin, ndonjëherë edhe në heshtjen e tyre, duke thënë se kjo botë dhe kjo jetë janë të padurueshme. Prandaj nevoja e njeriut për gëzim, për kuptim, për pavdekësi, për diçka që nuk është e kësaj bote fizike dhe materiale është e përhershme dhe nuk mund të kënaqet plotësisht me asgjë tjetër, nëse jo me bukurinë dhe dashurinë e pafund të Zotit, e cila pikërisht për këtë arsye përqafton realitetin tonë njerëzor në personin e Jezu Krishtit.

Nga përshkrimi i shkurtër i këtij realiteti në të cilin jetojmë sot, kuptojmë se njeriu pa Zot mbetet i vogël, i vetëm, i sëmurë, i dëshpëruar dhe pikërisht për këtë ka nevojë të rritet vazhdimisht, të integrohet në shoqëri, të shërohet dhe kështu të rizbulojë dinjitetin e shenjtë që ju dha nëpërmjet lindjes në fe, shpresë dhe dashuri.

Le të vazhdojë të shkëlqejë mbi të gjithë ne drita e Krishtit, e cila ndriçon natën e jetës së Betlehemit, duke na udhëhequr në rrugën e besimit dhe dashurisë vëllazërore. Në këtë kohë festash, të ripërtërijmë angazhimin tonë për të jetuar dashurinë e Ungjillit në çdo gjest, në çdo fjalë dhe në çdo akt shërbimi ndaj vëllezërve dhe motrave tona. Lindja e Jezusit, Shpëtimtarit tonë, i sjellte shpresë dhe forcë secilit prej nesh për të përballuar me besim sfidat e vitit të ri 2025. Paqja e Krishtit të banojë në zemrat tona dhe të shtrihet tek të gjithë njerëzit që takojmë. Ju uroj një Krishtlindje plot bekime, gëzim dhe paqe, dashuria e Krishtit ju shoqëroftë gjithmonë!

Don Antoni



“Shtegtar është ai që shkon në një vend që nuk është i tij, dhe kthehet në vendin e tij me pasuri shpirtërore!” thoshte Shën Agustini.

I frymëzuar nga kjo thënie e Shën Agustinit dhe, pa dyshim, nga vendi i shenjtë pranë Zojës së Fatimës, dua të ndaj me ju një përvojë të shtegtimit tim dhe pasurinë shpirtërore që mora nga Shenjtërorja e Zojës së Fatimës.

Pelegrinazhi në Portugali, në Fatima, me Misionin Katolik Shqiptar të Luzernit, ishte një pasuri shpirtërore. Me plot bindje e them se për

mua ishte një rritje për besimin tim personal dhe një kënaqësi e veçantë për mundësinë e dhënë për të qenë pjesë e këtij grupi prej 50 besimtarësh në Fatima, vendin ku Zoja e Bekuar ju është shfaqur tre fëmijëve për gjashtë muaj radhazi në vitin 1917.

Lutjet e shumta, si në nivelin personal ashtu edhe ato të shprehura si bashkësi, vendet e shenjta, kishat e bukura, shpjegimet nga misionari Don Antoni bënë të mundur, që të depërtojmë në misterin e këtij vendi, dhe përjetimi të ishte sa më i plotë.

Përveç aspektit shpirtëror dhe të fesë, ky shtegtim ishte edhe një kohë e bukur me njeri-tjetrin, për t'u njohur, ndarë kohë të përbashkët dhe për të shijuar miqësinë, që është një dhuratë dhe si të tillë e shijuar dhe na shoqëroi gjatë shtegtimit. Kjo për të theksuar, se Hiri i Zotit, prek të gjitha dimensionet e njeriut, duke e pasuruar atë. E tillë ishte dhe shtegtimi ynë, i pasuruar me praninë e Zojës, lutjen, besimin e thellë, njeri-tjetrin, dhe të gjithë ata që kujtuam dhe bartëm në mendjen e në lutjet tona gjatë këtij shtegtimi.

Po ashtu, devocioni që gjen në këtë vend, mijëra njerëz me përshpirtëri dhe fe të fortë



(Foto: Nikollë Ukaj)



(Foto: anonim)

janë gjunjësuar para këtij misteri e mrekullie, derdhin lutjet, njetet, vuajtjet, falënderimet dhe ja besojnë jetën e vet Zojës. Aty ndjehen të dëgjuar e të dashur. Edhe pse në gjuhë të ndryshme e kombe të ndryshme, të ardhur nga kudo, të gjithë ndjehen bij dhe bija të Hyjit. Kjo përvojë e përjetim, është një moment hiri e paqe që na u mundësua dhe që do të më shoqërojë gjatë jetës. Prandaj, me ndjenja gëzimi e falënderimi për secilin që ndamë momente të përbashkëta, me plot kujtime të bukura si në aspektin arkitekturor ashtu edhe shpirtëror, me fjalët plot informacion e frymëzim të misionarit Don Antonit, ky shtegtim realizoi fjalët e Shën Agustinit ku u kthjem më të pasur.

Jam i sigurt që ky shtegtim do të na ndihmojë që të reflektojmë e angazhohemi për një jetë më të thjeshtë, më të mirë, të punojmë më shumë në jetën shpirtërore dhe sakramentale, duke pasur një devotshmëri të veçantë ndaj Nënës sonë Qiellore, Zojës së Bekuar, Zojës së Fatimës.

Ky shtegtim shpirtëror, që bashkoi besimtarët nga të gjitha anët, dhe shumicën e tyre që



(Foto: Tomë Lazri)

jetojnë në Zvicër, krijoi një dëshirë të thellë për të forcur lidhjet tona me Jezusin, Zojën e Bekuar dhe me njëri-tjetrin.

E përfundoj këtë përvojë të shtegtimimit me fjalët plot shpresë të Biblës: “Bijtë e Hyjit janë ata që i udhëheq Shpirti Hyjnor.” Të udhëhequr nga kjo frymë hyjnore dhe të frymëzuar nga Virgjëra Maria, vendosa të ndaj përvojën time të shtegtimimit në Portugali me lexuesit dhe besimtarët e revistës “Misioni Ynë.”

Shkruan: Nikollë David Ukaj, Stubëll



FORUMI I GRAVE

(Foto: don Anton Ulka)

Më 14 tetor në qendrën e Misionit tonë në Luzern u zhvillua takimi me gratë e stafit të ngushtë të Forumit të Gruas. Takimi u zhvillua me kërkesën e vetë grave, të cilat donin të bënin një takim të lirë ku të bisedonin, të ishin bashkë dhe të njiheshin më mirë me anëtarët e reja të Forumit të Grave. Ishte një mbrëmje shumë e pasur, ku u shkëmbyen njohuri, ku u shfaqën përvoja të ndryshme jetësore të të gjitha të pranishmeve, dhe shumë gjëra të tjera që lidhen me punën, aktivitetet dhe kujdesin ndaj Misionit tonë, për të cilin janë të përkushtuar të gjithë dhe që kanë kujdes të madh dhe dashuri për të mirën e Kishës në përgjithësi, sidomos për të ndihmuar të varfërit në mënyra të ndryshme.

Darkën e përbashkët e shtroi kryetarja e Forumit, zonja Lume Malota, të cilën e falënderojmë nga zemra. Duke shijuar atmosferën e përbashkët, ushqimin e ofruar dhe duke dëgjuar përvoja të ndryshme jetësore në atmosferë gëzimi, përfunduam këtë mbrëmje të këndshme. Falënderojmë Zotin që vazhdimisht na ka ofruar këto momente në Misionin tonë dhe falënderojmë çdo anëtare të Forumit të Grave për kontributin e tyre të çmuar.



(Foto: Valentina Prenrecaj)



Shkruan: m. Vida Ademi (Foto: anonim)



TAKIMI I GRAVE TË TRE MISIONEVE KATOLIKE SHQIPTARE NË ZVICËR

(Foto: anonim)

Më 26 tetor u mbajt takimi i grave të tre Misioneve Katolike Shqiptare në Misionin në Thurgau në Sirnach. Të gjitha së bashku ishin rreth 160 gra. Duke qenë se numri ishte i kufizuar, nga Misioni ynë udhëtuam një autobus dhe një autobus nga Aarau. Takimi u organizua nga motrat e nderit, së bashku me Forumin e Grave, të cilat shërbejnë në Mision në Thurgau. Pritja ishte shumë e përzemërt nga ana e motrave dhe grave të Misioni. Për këtë rast kemi ftuar m. Antoneta Pretashi nga Shqipëria për të mbajtur ligjëratën e cila erdhi me kënaqësi. Tema ishte: “Ajo që i beson Marisë kurrë nuk do të mbetet e zhgënjyer”. Në mes të tjerave m. Antoneta i porositi gratë: “Pa dyshim se çdo shtet dhe çdo shoqëri ka nevojë për rolin e gruas, për vlerat që prania e tyre sjellë. Maria është gjithmonë e dashur sepse është nënë dhe ajo është Nëna e Birit të Hyjit, ajo është nëna e secilës prej nesh, me të është mënyra më e mirë të jetojmë jetën tonë afër Jezusit. Jeta jonë do të ishte shumë e rëndë pa Marinë. Mos u lodhni së mbjelluri në shoqërinë tonë ato

fara që ju dini ti mbillni aq mirë dhe aq bukur: dhembshurinë, butësinë, devotshmërinë, qëndrueshmërinë, sakrificën dhe dashurinë, sepse ato me siguri do të japin fruta, të cilat do i shijojmë si ju ashtu edhe të gjithë ata që jetojnë me ju me këto virtyte e bekime.”

Pas ligjëratës u kremtua mesha shenjte të cilën e udhëhoqi don Marijan Lorenci, misionar në Sirnach. Pas meshës ishte dreka e përbashkët e ofruar nga Misioni në Thurgau. Pas dite programi ka vazhduar me shoqërim, këngë, valëzime, barsoleta ku të qeshurat nuk munguan. Gjatë programit të pasdites ishte dëshmia e bashkëshortëve Shinit dhe Dritës, si dhe ajo e Lurdes për shtegtimin e tyre në këmbë, Jakobs-weg nga Sirnach për në Lurd dhe nga Lurdi për në Santiago de Compostela, Spanjë.

Ishte vërtetë një përvojë shumë bukur në përshpirtëri dhe gëzim. Për gjithçka falënderojmë Zotin, m. Antoneta Pretashi por edhe të gjithë ata që kontribuuan për këtë takim kaq të bukur.

Shkruan: m. Vida Ademi



SHËTITJA E MINISTRANTAVE NË EUROPAPARK

(Foto: anonim)

Me 2 nëntor të këtij viti u mbajt shëtitja vjetore me Motrat që shërbejnë në Luzern, me ministrantët dhe prindërit e tyre në Europapark.

Ministrantët i zbukurojnë të gjitha kremtimet Liturgjike në të cilat marrin pjesë duke i shërbyer meshtarin, kështu që Misioni në shenjë falënderimi për këtë i ka shpërblyer ata me

një ekskursion në Europapark, në Gjermani.

Atë ditë edhe ne prindërit ishim shumë të lumtur me fëmijët tanë për pjesëmarrjen në këtë shëtitje. Ne rrugëtim drejt Gjermanisë kemi lutur Zotin, kemi kënduar këngë shpirtërore dhe popullore. Ishte një udhëtim shumë frymëzues për fëmijët dhe për të rriturit sepse patëm mundësi të qëndrojmë së bashku dhe të ndajmë çaste të bukura me njëri-tjetrin.

Me një mot të mirë dhe ambient të bukur, edhe pse të mbushur me njerëz, as fëmijët e as të rriturit nuk përtuam të prisnim në rreshta të gjatë për t'i shijuar lodrat e ndryshme argëtuese dhe ushqimet e shijshme të atij vendi. Lojërat e ndryshme janë të përshtatshme qoftë për fëmijët por edhe për të rriturit.

Pas një dite plot përvoja të ndryshme ishte kënaqësi rikthimi në shtëpitë tona së bashku me pjesëmarrësit duke u lutur, kënduar dhe bashkëndarë çaste të mira.

Falënderojmë misionarin tonë don Antonin, motër Mrikën dhe motër Vidën edhe për këtë organizim të veçantë për fëmijët tanë dhe për ne prindërit.



(Foto: anonim)

Shkruan: Blerta Dushaj, Zug



DASHURI QË VAZHDON TË JETOJË...

Para 156 vitesh, një grua me emrin Franziska Lechner, e përfshirë nga dashuria për Zotin dhe njerëzit, themeloi një shoqatë motrash dhe i dha emrin më të bukur që ekziston. „Bijat e Dashurisë Hyjnore“. Pjesë e kësaj shoqate janë edhe motrat tona, që shërbejnë këtu në Luzern dhe në Misionin e Thugau-t. Vepra e Franziska Lechner vazhdon të frymojë kudo ku ka Bija të Dashurisë Hyjnore. Ato mundohen ta qojnë përpara misionin e Themeluese së tyre të dashur përmes motos që ajo aq fort e kishte për zemër, „Bëni mirë, dhuroni gëzim, dhe udhëhiqni të gjithë njerëzit në qiell“. Këtë gjë mundohen edhe motrat me shërbimin e tyre mes njerëzve dhe për njerëz.

Me rastin e përkujtimit të përvitshëm të ditës së themelimit të Kongregatës, më 21 nëntor, motrat organizuan një meshë solemne dhe një darkë të përbashkët me të gjithë misionarët që punojnë për misionet shqiptare këtu në Zvicër. Meshën u udhëhoqi dom Marjan Demaj, misionar në Aarau ku bashkëkremtuan dom Marijan Lorenci dhe dom Anton Uka. Në predikimin e tij, dom Marjani theksoi rëndësinë e kushtimit tonë Zotit, sipas shembullit të Zojës së bekuar. Një kushtim i plotë, pa kushte dhe mbi të gjitha,

një kushtim plot gëzim. Në darkën e përbashkët mbizotëroi një klimë e bukur mes nesh, e mbushur me biseda dhe bashkëndarje.

Falënderojmë Zotin që botën e ka zbukuruar me këtë Kongregatë e cila vazhdon pandërprerë duke dhënë fryte të shumta, që ndoshta shpesh nuk i shohim por, Zoti ynë i mirë i sheh dhe i vlerëson.

Shkruan: m. Luiza Milani, FDC, Sirnach



(Foto: anonim)



SHËN ÇEÇILIA, PAJTORE E MUZIKANTËVE DHE KËNGËTARËVE

(Foto: R.V.)

Festën e Shën Çecilies, pajtorës së muzikantëve dhe këngëtareve, e në veçanti të atyre që më artin e tyre kontribuojnë për bukurinë e meshës së shenjte dhe kremtimeve të tjera liturgjike, festohet më 22 nëntor.

Çecilia lindi në fillim të shekullit të tretë pas Krishtit. Është rritur dhe edukuar në familje të krishterë. Ajo jetën e saj ia kushtoi Zotit se do të jetojë në pastërti e nuk do të martohet, megjithatë prindërit e martuan për Valerianin, që ishte pagan, por me kërkesën e saj ai pranoi prej shenjtëreshës gjithçka i kërkoi, pra ia plotësoi dëshirën dhe jetuan në pastërti. Valeriani më vonë është pagëzuar dhe

është martirizuar për shkak se nuk dëshoi të nderojë zotët romak gjë që i ishte kërkuar. Shën Çecilia është dënuar për shkak se ishte e krishterë dhe më parë ka pranuar martirizimin se të lërë fenë e vet, kështu edhe ndodhi. Para se të vdiste gjithë pasurinë e saj ia dhuroi Kishës dhe të varfërve. Ajo është varrosur në katakombet e Kalistit. Mendohet se Çecilia gjatë jetës së vet ishte aq afër qiellit, sa që ka mundur të dëgjojë këndimin e engjëjve. Flitet se ajo ka qenë e aftë të luajë muzikë në instrumente të ndryshme. Për këtë nderohet si pajtore e muzikës dhe e muzikantëve dhe këngëtarëve.

Në këtë ditë Kori i Misionit tonë në Luzern, pas provave të rregullta çdo të premte, kremtoi së bashku pajtorën e tyre, Shën Çecilien. Misioni Korit ofroi darkën, kështu që të gjithë së bashku qëndruan në shoqëri, duke biseduar dhe duke shkëmbyer biseda me njëri-tjetrin. E lusim Shën Cecilien për çdo anëtarë të Korit, që ajo t'i shoqërojë me ndërmjetësimin e saj dhe t'i shpërblejë për gjithçka që bëjnë për Zotin, Kishën dhe Misionin tonë.



(Foto: Linda Milici)

Shkruan: Redaksia



TURNIRI NË PINGPONG

(Foto: Gaspër Merturi)

Më 9 nëntor 2024 u mbajt me sukses turneu i pingpongut në të cilin morën pjesë 40 garues të moshave të ndryshme, shumë të tjerë erdhën për të parë dhe për të kaluar një mbrëmje së bashku në Mision.

Organizimi, falë Leonard Komanit, Armend Imerit, Valon Nushit, Albert Nikollës, Avgustin Ramës, Gazmend Dedajt dhe Zef Ramës dhe shumë të tjerëve që u përfshinë në këtë turne, ishte i një niveli të shkëlqyer dhe pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur. Në fillim të mbrëmjes të pranishmit e uruan Don Antonin për ditëlindjen e tij të 45-të duke kënduar dhe duke u shërbyer me nga një gotë verë, më pas u hodh shorti për turneun.



(Foto: Nue Tuqi)

Pas shumë ndeshjesh u shpallën fituesit: vendi i parë Betim Biba, vendi i dytë Mesur Mehmeti, vendi i tretë Fanol Nushi. Tre të klasifikuarit më të mirë iu dha një çmim simbolik.

Falë njerëzve të gatshëm për organizim dhe shërbim, si dhe falë pjesëmarrësve në lojë dhe këtë mbrëmje sportive e miqësore, në këtë turne u mblodhën 1630 franga dhe 60 euro, të cilat do të dhurohen për bamirësi.

Falënderojmë të gjithë ata njerëz që na ndihmuan të organizojmë dhe të krijojmë një turne dhe mbrëmje kaq miqësore.



(Foto: Gaspër Merturi)

Shkruan: Redaksia



Të shtunën më 23 nëntor, në Emmenbrücke të Luzern-it, në një atmosferë të mbushur me frymëzim dhe krenari, para qindra bashkëvendësve, Misioni Katolik Shqiptar në Luzern dhe Shoqata Bamirëse „Nënë Tereza“ në Zvicër, organizuan mbrëmjen kulturore, edicionin e dytë më radhë, të titulluar «Gjurmëve të rrënjëve tona», një aktivitet që bashkoi bashkësinë shqiptarë në Zvicër e më gjerë, për të nderuar dy figura të ndritura të qytetërimit shqiptar dhe botëror: Shën Jeronimin dhe Shën Nënë Terezën. Moderatorët Znj. Jehona Gashi dhe z. Dan Morina më një elegancë të jashtëzakonshme dhe në mënyrë profesionale udhëhoqën këtë mbrëmje të mrekullueshme kulturore.

Kori i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern i udhëhequr me profesionalizëm nga motra Mrikë, interpretoi Himnin e Shën Nënë Terezës.

Mbrëmjen e edicionit të dytë “Gjurmëve të rrënjëve tona” e hapi me një fjalë përshëndetëse dhe plot ngrohtësi Misionar i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, Dr. Don Anton Uka, duke i dhënë vlerën këtij aktiviteti të veçantë dhe duke theksuar rëndësinë e kujtesës dhe nderimit të këtyre figurave për të tashmen dhe të

ardhmen tonë. Kumtesa e tij ishte një vështrim i Gjurmëve të rrënjëve me titull: “Rrënjët tona na bashkojnë”.

Të gjithë të pranishmit dhe këtë event të mrekullueshëm, me një përshëndetje të ngrohtë e përshëndeti konsulli i Kosovës në Zürich z. Vigan Berisha, i cili shprehu vlerësimin e tij për organizatorët dhe theksoi rëndësinë e nderimit të trashëgimisë sonë shpirtërore dhe kulturore. Ai vuri në pah rolin e këtyre dy figurave madhore si frymëzim për bashkimin e vlerave kombëtare me ato universale.

Profesor doktor Muhamet Malaj, mik i ftuar nga Kosova, për këtë mbrëmje, ligjëroi nga punimi i tij i titulluar: “Shën Jeronimi, urë lidhësi mes Ilirisë dhe botës perëndimore në shërbim të Fjalës së Shenjtë”, ligjëratë e thelluar dhe frymëzuese. Në këtë ngjarje të veçantë, vështrimi i tij ndriçoi jetën dhe veprën e Shën Jeronimit. Ai solli një reflektim të gjerë mbi jetën dhe trashëgiminë kulturore duke theksuar kontributin e jashtëzakonshëm të këtij gjiganti për qytetërimin e botës. Ai theksoi: edhe pse është një figurë universale e krishterimit, vlerësohet si një personalitet me rrënjë iliro-shqiptare. Ai është

përkthyesi i parë i Biblës në latinisht (Vulgata), duke e bërë Fjalën e Shenjtë të kuptueshme jo vetëm për botën e atëhershme. Profesor Malaj ndër të tjera theksoi së Shën Jeronimi, i njohur si një nga figurat më të shquara të krishterimit të hershëm, mbetet një urë lidhëse e fuqishme mes kulturës ilire dhe qytetërimit perëndimor. Duke qenë me origjinë ilire, ai mishëron lidhjen shpirtërore dhe kulturore mes trojeve tona dhe botës së krishterimit universal. Shën Jeronimi lindi në vitin 347 në Stridon, një vendbanim që besohet se ndodhej në zonat ilire. Edhe pse kufijtë gjeografikë të asaj kohe nuk përcaktojnë saktësisht vendndodhjen, ai mbart me vete frymën dhe pasurinë kulturore të Ilirisë, një rajon që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në historinë e qytetërimit perëndimor.

Kurse Monsinor Dr. Don Lush Gjergji, një nga njohësit më të afërt të jetës dhe veprës së Shën Nënë Terezës, foli lidhur me temën: „Nënë Tereza në 45-vjetorin e marrjes së Çmimit Nobel për Paqe”. Ai ritheksoi përjetimet më rastin e ndarjes së çmimit Nobel për Paqe, Nënë Terezës. Nga ana tjetër, Don Lush Gjergji ndau me të pranishmit reflektime të thella mbi jetën dhe veprën e Shën Nënë Terezës, duke kujtuar përkushtimin e saj të palodhshëm ndaj më të varfërve dhe porositë e saj për dashurinë, humanizmin dhe paqen. Në mënyrën që mundet vetëm Dr. Don Lushi Gjergji, risolli në mendje kujtimet e dhjetorit të vitit 1979, ku ai bashkë me ipeshkvin e Kosovës monsinqor Nik Prelën dhe vëllain e saj Lazer Bojaxhiun, shoqëruan Nënë Terezën në këtë ceremoni, duke përshkruar momentin e marrjes së çmimit Nobel për Paqe, dhe tha: “Komisioni për shqyrtimin e Kërkesave të paraqitur shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga anëtarë i komisionit për ndarjen e Çmimit Nobel për Nënë Terezën dhe një zëri komisioni mori Vendim dhe ndau Çmimit Nobel për Paqe për Gonxhe Bojaxhiun e njohur në tërë botën si Nëna Terezë, që ju dorëzua në Oslo më 10.12.1979.” Ndër të tjera ai ndau reflektime të thella mbi përkushtimin dhe misionin e saj të dashurisë dhe humanizmit, duke e lidhur figurën e saj me nevojat shpirtë-

rore të kohës sonë.

Një moment i veçantë i mbrëmjes ishte prezantimi i librit të Don Lush Gjergjit, të titulluar «Porositë e Shën Nënë Terezës për ne», i prezantuar nga Z. Bardhec Berisha.

Kurse kryetari i Shoqatës Humanitare Nënë Tereza, z. Nue Zalli përmbylli këtë mbrëmje kulturore. Ndër të tjera theksoi se: Këto të dy figura tona të përbashkëta kanë dijen, besimin, dhe dhuratën në dobi të njerëzimit. Në përfundim, falënderoj të gjithë ata që dhanë ndihmën e tyre për realizimin e këtij aktiviteti dhe për ata që e bënë të paharrueshme këtë natë të mbushur me kulturë, frymëzim dhe dashuri për trashëgiminë tonë kombëtare.

Kjo mbrëmje ishte një dëshmi e fuqishme e lidhjes sonë me rrënjët tona dhe e aspiratës për të ndjekur dritën dhe udhëzimet që këta dy gjigantë na kanë lënë. Ai falënderoi Monsinor Dr. Don Lush Gjergjin, Prof. Dr. Muhamet Malaj, drejtorin e shoqatës Nënë Tereza në Kosovë z. Zef Shalën; moderatorët e nderuar Johona Gashi dhe Dan Morina; ansamblin Shqiptarja dhe këngëtarën Fatime Kalimashi; aktorin Mustaf Shabani; korin e Misionit Katolik Shqiptar në krye me motrat e nderit, dhe vullnetarët e shumtë të cilët kanë qenë të gatshëm për të ndihmuar në organizimin dhe realizimin e kësaj mbrëmje kulturore; Kastriot dhe Vera Frrokaj për Apon, dhe piktorët: Arsim Berisha, Daniel Rosaj, Pren Berisha dhe Xholec Deda.

Këngëtarja Fatime Kalimashi më këngët e saj për Shën Nënë Terezën, përcjellë nga ansambli “Shqiptarjat” e bënë edhe më madhështore këtë mbrëmje kulturore. Kurse aktori Mustaf Shabani u paraqit me një monolog kushtuar Nënë Terezës.

Kjo mbrëmje ishte një kujtesë e fuqishme për rrënjët tona të pasura kulturore dhe shpirtërore, si dhe një nxitje për të ndjekur vlerat universale të këtyre dy personaliteteve që mbeten pishtarë të qytetërimit shqiptar dhe botëror.

Shkruan: Bardhec Berisha – Bardhi, Neudorf



FESTA E KRISHTIT MBRET

“Rroftë Krishti, Mbreti ynë! Rroftë Shqipnja dhe Shqiptarët e vërtetë!”

Nën moton e martirëve të popullit tonë dhe Kishës sonë, në Emmenbrücke, më 24 nëntor 2024, u kremtua me solemnitet të madh festa e Krishtit Mbret dhe festa e flamurit kombëtar.

Kremtimi i meshës nisi me procesionin solemn të mbushur me fëmijë dhe të rinj të veshur me veshje kombëtare, të cilët, nën tingujt e muzikës dhe këngëve të kënduara me profesionalizëm nga kori ynë, iu afruan altarit të shenjtë, i rrethuar nga figurat e martirëve, shenjtërve dhe simboleve tona kombëtare, të cilat prisnin që ne të afrohem në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë dhe kështu të lavdërojmë dhe bekojmë Zotin.

Kisha ishte e mbushur plot me besimtarë, miq dhe përкахës, të cilët erdhën për tu lutur së bashku dhe për të falënderuar Zotin për të gjitha të mirat që kemi në jetën tonë, në familje, në Kishë dhe në popull.

Kjo meshë u drejtua nga Don Lush Gjergji, prifti i dashur dhe i respektuar nga të gjithë.

Në predikimin e këtij rasti, Don Lushi foli për të gjitha ato vlera shpirtërore dhe kulturore që jemi të thirrur t'i ruajmë dhe kultivojmë. Don Lushi po ashtu shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për këtë festë kaq madhështore dhe kaq të mbushur me vlera fetare dhe kombëtare.

Gjatë meshës u bë edhe pagëzimi i një vajze të re, e cila, pas përgatitjes fetare dhe shpirtërore, pranoi sakramentet e fillimit të jetës së krishterë.

Në këtë festë mori pjesë edhe miku ynë Valon Islamaj, i cili së bashku me gruan e tij patën ardhur për të festuar me ne, duke na dhuruar dy këngë shumë të bukura që ngjallën tek të gjithë të pranishmit emocione mirënjohjeje dhe krenarie për atë që jemi dhe kemi si popull i lashtë i Evropës.

Për të gjitha këto falënderojmë Zotin, bashkëpunëtorët tanë të shumtë, miqtë dhe dashamirët që na mbështesin në misionin tonë të shenjtë në shërbim të Kishës dhe të popullit.

Shkruan: Redaksia



Nga shtatori i këtij viti filluam përgatitjen me të rinjtë dhe të rejat (32 persona) që do të marrin sakramentin e Krezmimit vitin e ardhshëm. Kjo përgatitje synon të sigurojë që kandidatët të fitojnë njohuritë themelore të fesë dhe kështu të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që marrin përsipër duke pranuar sakramentin e krezmimit. Këto takime përgatitore favorizojnë dhe nxisin edhe njohjen dhe miqësinë mes tyre.

Meqenëse këta të rinj kanë lindur dhe janë rri-

tur në Zvicër, vështirësitë në të kuptuarit e plotë të gjuhës shqipe janë të natyrshme, prandaj ne si edukatorë të tyre përpiqemi tju ndihmojmë duke ju shpjeguar konceptet edhe në gjermanisht. Nga takimet e deritanishme del se ky grup të rinjsh janë shumë të kënaqur me përvojën që po përjetojnë dhe afërsia e tyre me kishën, meshtarin dhe murgeshat ka një rëndësi të veçantë në formimin e tyre fetar dhe shpirtëror.

Shkruan: Redaksia

28 Nëntori

Me ftesë të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë, z. Mustafa Nano, misionari ynë Don Anton Uka së bashku me kryetarin e Këshillit të Misionit z. Nue Tuqin morën pjesë në mbrëmjen festive për nder të Festës së Ngritjes së Flamurit dhe festës së Pavarësisë që u mbajt më 28 nëntor në Bern.

Në mbrëmje morën pjesë ambasadorë, politikanë, profesorë, priftërinj dhe njerëz nga sektorë të ndryshëm, të cilët erdhën për të urrear trupin diplomatik të Shqipërisë në Zvicër dhe për të festuar së bashku festën e Pavarësisë së Shqipërisë.

Për nder të kësaj feste, është traditë që ambasadori ti përshëndesë pjesëmarrësit me një mirëseardhje dhe një mesazh për të gjithë të pranishmit.

Këto festa janë gjithashtu ideale për të takuar dhe ndarë përvojat me njerëz nga sektorë të ndryshëm.

Në takimin e shkurtër që pati me ambasadorin e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, Don Antoni shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij, ndërsa nënvizoi nevojën për një bashkëpunim më të thellë ndërmjet institucioneve tona.

Shkruan: Redaksia



TAKIM MES PËRFAQËSUESVE TË BASHKËSIVE FETARE SHQIPTARE NË ZVICËR

(Foto: Albinfa)

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tolerancës, Konsullata e Republikës së Kosovës në Zürich organizoi një takim të rëndësishëm me përfaqësues dhe klerikë të komuniteteve fetare shqiptare në Zvicër. Ky takim u mbajt me qëllim forcimin e unitetit dhe ruajtjen e identitetit kombëtar, duke bashkuar figurat kryesore të komunitetit mysliman dhe katolik shqiptar në Zvicër, si dhe duke promovuar tolerancën dhe bashkëpunimin ndërmjet feve.

Në këtë ngjarje morën pjesë figura të njohura të bashkësive të ndryshme, Mehas Alija, Kryetar i Komunitetit Mysliman në Zvicër, dhe

Don Anton Uka, përfaqësues i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern. Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit: Don Marjan Marku, Don Marjan Demaj, Fehim Abazi, Halil Avdulli dhe Pashk Çeta.

Konsulli i Republikës së Kosovës, z. Vigan Berisha, në fjalën e tij përshëndetëse gjatë takimit me përfaqësuesit dhe klerikët e komuniteteve fetare shqiptare në Zvicër, vlerësoi rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ruajtjen e unitetit dhe identitetit kombëtar.

“Konsullata jonë do të mbetet gjithmonë një derë e hapur për çdo nismë që synon të forcojë unitetin, bashkëpunimin dhe ruajtjen e identitetit tonë kombëtar,” deklaroi ai, duke theksuar se roli i bashkësive fetare është i një rëndësie të veçantë në ndërtimin e urave të solidaritetit dhe në edukimin e brezave të rinj me vlera kombëtare e njerëzore.

Konsulli Berisha vuri në pah rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe Bashkësive fetare për të ruajtur gjuhën dhe kulturën kombëtare, duke veçuar mësimin plotësues në gjuhën shqipe si një shtyllë kryesore të këtij misioni. “Mësimi në gjuhën shqipe jo vetëm që ndihmon fëmijët tanë të njohin rrënjët



(Foto: Albinfa)

e tyre, por gjithashtu garanton që gjuha jonë e bukur të mbetet e gjallë në brezat e ardhshëm, përbalë sfidave të asimilimit”, theksoi ai.

Në vijim, Konsulli theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe të harmonisë ndërmjet bashkësive fetare shqiptare, si një model që përçon mesazhe të fuqishme uniteti. “Në një botë ku ndarjet shpesh i tejkalojnë kufijtë kulturorë dhe fetarë, është jetike që mërgata jonë të dëshmojë se bashkimi është çelësi i suksesit. Roli juaj, si udhëheqës shpirtërorë, është i një rëndësie të madhe në këtë drejtim”, u shpreh ai.

Berisha përmbylli fjalën e tij duke shprehur mirënjohje për përpjekjet e palodhshme të klerikëve në shërbim të bashkësisë shqiptare në Zvicër. “Ju falënderoj për përkushtimin tuaj dhe për rolin që luani në forcimin e unitetit tonë kombëtar dhe shpirtëror. Ky takim le të jetë një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit edhe më të ngushtë në të ardhmen. Gjithmonë do të keni mbështetjen tonë në misionin tuaj fisnik për të ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditat tona,” përfundoi Konsulli, duke uruar suksese të përbashkëta.

Mehas Alija, Kryetar i Bashkësisë Myslimane në Zvicër, theksoi se në Ditën Ndërkombëtare të Tolerancës, fetë janë burimi kryesor i frymëzimit për të promovuar mirëkuptimin dhe harmoninë ndërfitare e ndërnjerëzore. Ai vlerësoi takimin e organizuar nga Konsulli i Kosovës, z. Vigan Berisha, si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit mes prijësve fetarë shqiptarë në Zvicër.

Alija nënvizoi rëndësinë e ruajtjes së vlerave kombëtare, gjuhës dhe identitetit, duke shërbyer si model bashkimi për shqiptarët, veçanërisht në Ballkan. Ai theksoi gjithashtu domosdoshmërinë e projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunimit me bashkësitë e tjera, për të forcuar identitetin fetar dhe kombëtar, duke qenë shembull i qytetërimit dhe harmonisë.

Don Anton Uka, përfaqësues i Misionit Katolik Shqiptar në Zvicër, e vlerësoi takimin e organizuar më 18 nëntor në Konsullatën e Kosovës në Zvicër si shumë të frytshëm dhe me domethënie të veçantë. Ai falënderoi Konsullin,

z. Vigan Berisha, për organizimin në kuadër të Ditës Botërore të Tolerancës, duke theksuar se ky takim shërbeu për t'u njohur më mirë si individë dhe si institucione fetare katolike dhe myslimane.

Uka nënvizoi se trashëgimia dhe historia kombëtare shqiptare janë unike në botë dhe se për shqiptarët, toleranca shkon përtej saj, duke u shndërruar në një vëllazëri të vërtetë. “Edhe pse të ndarë në religjione, historia jonë ka treguar se kjo nuk është pengesë për bashkëpunim. Përkundrazi, është një mundësi për të forcuar lidhjet tona dhe për ti shërbyer më mirë bashkësisë shqiptare që jeton dhe vepron në Zvicër,” përfundoi ai.

Pashk Çeta, përfaqësues nga Misioni Katolik i Shqiptarëve në Zvicër në Argau dhe pasardhës i pajtuesit të njohur të gjaqeve, Anton Çeta, theksoi veçantinë e Misionit Katolik Shqiptar në Zvicër, duke vënë në dukje se përveç meshëve që mbahen në gjuhën shqipe, ky mision organizon edhe aktivitete kulturore, si grupet artistike të vallëzimit. Në Luzern, funksionon Grupi i Vallëzimit “Shqiponja”, ku marrin pjesë anëtarë të çdo moshe, ndërsa në Thurgau është Grupi i Vallëzimit “Arbëreshët”, i njohur për përgatitjen e tij të shkëlqyer. Po ashtu, në Aarau, grupi i vallëzimit është në fazën e organizimit dhe përgatitjes. Këto aktivitete, sipas Çetës, janë një dëshmi e angazhimit të Misioneve Katolike Shqiptare në Zvicër për ruajtjen e traditave dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Takimi në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Zürich, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tolerancës, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet bashkësive fetare shqiptare në Zvicër. Fjalët e Konsullit Vigan Berisha dhe përfaqësuesve të tjerë riafirmuan angazhimin për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor, si dhe për forcimin e solidaritetit dhe harmonisë ndërmjet shqiptarëve në diasporë. Ky takim ishte një hap i rëndësishëm drejt një bashkëpunimi të ngushtë dhe një modeli uniteti dhe tolerancë ndërkulturore.

(Shkruan: Luljeta Ademi. Marrë nga albinfo.ch)

TESTOJE NJOHURINË TËNDE MBI KRISHTLINDJEN

Festa e Krishtlindjes është aq e veçantë dhe e pasur me simbole dhe rituale sa rëndësinë e saj. Prandaj, përmes këtij testi të shkurtër dëshirojmë të japim disa besimin tonë të krishterë. Krishtlindja është festa e preferuar e të gjithëve, por Testoje veten me këtë Kuiz duke shkruar shkronjat e sakta sipas mendimit tuaj.

1 Pse Kisha Katolike feston Krishtlindjen më 25 dhjetor?

- A Sepse Jezusi lindi në të vërtetë më 25 dhjetor të vitit të parë të Erës së Re.
- K Sepse kjo datë ekzistonte si festë pagane e solstici-t të dimrit (nata më e gjatë e dimrit) dhe u zëvendësua me lindjen e Diellit të ri - Jezusit (Natalis Solis Invicti).
- L Sepse tekstet biblike tregojnë se Jezusi ka lindur më 25 dhjetor.

2 Kush ishte Maria për Jozefin përpara se të ngjizte Jezusin?

- T Maria ishte gruaja e Jozefit dhe ata tashmë prisnin një fëmijë.
- C Maria ishte një mike shumë e dashur e Jozefit.
- R Maria ishte e fejuara e Jozefit dhe ishte shumë e re.

3 Çfarë do të thotë emri Jezus?

- I Emri Jezus ka një kuptim të thellë biblik për faktin se përm-bush premtimet e Besëlidhjes së Vjetër për shpëtimin e popullit të Zotit, prandaj domethënë Hyji shpëton.
- B Profetët kishin paralajmëruar se Mesia do të ishte mbrojtësi i Izraelit, kështu që ky emër do të thotë: Zoti mbron.
- S Në personin e Jezusit manifestohet mirësia e Zotit, prandaj emri Jezus do të thotë Zoti është i mirë.

4 Në cilin vend ka lindur Jezusi?

- D Jerusalemi është vendlindja e Jezusit.
- S Tekstet biblike tregojnë se Jezusi lindi në Betlehem.
- T Katër ungjilltarët tregojnë qartë se Jezusi lindi në Nazaret.

5 Cili ishte lajmi që engjëjt ju dhanë barinjve?

- P Shkoni dhe tregoni Jozefit dhe Marisë se Herodi ka vendosur të vrasë Jezusin.
- K Le të shkojmë në Betlehem dhe të shohim ngjarjen që Zoti na kumtoi.
- H Mos kini frikë! Sot, në qytetin e Davidit, ju lindi Shëlbuesi: Krishti Zot!

SHTLINDJEN

a që ndonjëherë rrezikohet të kalohet pa e kuptuar plotësisht kuptimin dhe a informacione të rëndësishme për këtë festë kaq domethënëse për jetën dhe kush mund të thotë se ata janë njohës të vërtetë të kësaj feste kaq të bukur? në kutitë e mëposhtme dhe do të zbuloni fjalën magjike.

6 Cilët janë emrat e tre mbretërve?

- F Mateu, Marku dhe Luka
- T Gaspër, Melkior dhe Baltazar
- G Baltazar, Gasper dhe Me-teon

7 Çfarë dhuratash i sollën tre mbretërit Jezusit?

- Q Ar, argjend dhe temjan
- Z Lule, ushqim dhe flori
- L Ar, temjan dhe mirrë

8 Pse Jozefi, Maria dhe Foshnja hyjnore ikën në Egjipt?

- T Për një jetë më të mirë.
- I Sepse Herodi kërkonte ta vriste Jezusin.
- U Sepse romakët i dëbuan nga shtëpia e tyre në Betlehem.

9 Çfarë ngjarje shënon festa e Fëmijëve të pafajshëm?

- V Kujtimin e atyre fëmijëve që vdiqën në moshë të vogël.
- P Shënon lindjen e të gjithë atyre fëmijëve që janë bashkëkohës të Jezusit.
- N Vrasjen nga Herodi i fëmijëve meshkuj të moshës 2 vjeç e poshtë.

10 Në cilin qytet e kaloi fëmijërinë Jezusi?

- C Në Kafarnaum
- D Në Nazaret
- S Në Jerusalem

11 Në cilin vit u krijua betlehemi i parë?

- U Në vitin 1220 papa Onorio i III shpiki betlehemin e parë.
- J Në vitin 1223 Shën Françesku i Asizit krijoi ambientin e lindjes së Jezusi dhe e quajti grazhd apo betlehem.
- E Betlehemi është shpikur në vitin 1321 nga një autor i panjohur.

12 Në cilin qytet ndodhet kisha apo bazilika ku lindi Jezusi?

- A Në Betlehem
- H Në Jerusalem
- R Në Nazaret

Përgatiti:

don Anton Uka, Luzern

Zgjidhja:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----



(Foto: Martin Musaj)

RRËNJËT TONA NA BASHKOJNË

Të nderuar meshtarë, motra të nderit, profesorë, përfaqësues të botës politike, artistë, piktorë, moderatorë, gazetarë dhe përfaqësues të medias, të nderuar pjesëmarrës dhe dashamirës të Misionit Katolik Shqiptar në Luzern dhe të Shoqatës Humanitare «Nënë Tereza» këtu në Zvicër, më lejoni tju përshëndes dhe t’ju uroj mirëseardhjen në edicionin e dytë të Gjurmëve të Rrënjëve tona, i cili këtë vit ka në fokus Shën Jeronimin dhe Shën Nënë Terezën, dy gjigantë të qytetërimit shqiptar.

Qëllimi apo ideja e fillimit të këtyre takimeve kulturore, sikurse është theksuar në edicionin e parë kushtuar arbëreshëve, lind nga një arsye e dyfishtë: së pari nga dëshira për të dhënë një kontribut që diaspora jonë shqiptare këtu në Zvicër të ruajë vetëdijen identitare dhe të risë përkushtimin ndaj kulturës, historisë, traditës, gjuhës, simboleve dhe figurave tona kombëtare dhe së dyti nga nevoja për t’u thënë jo atyre dukurive të dëmshme për traditën, gjuhën dhe kulturën tonë, që fatkeqësisht në Kosovën e pasluftës janë shfaqur edhe në institucionet fetare, kulturore dhe politike, detyra apo misioni i të cilëve do të duhej të ishte ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore, kurrsesi shkatërrimi apo deformimi i saj.

“Kush nuk i njeh rrënjët e veta nuk mund ta dijë për çka ka nevojë pema e jetës së tij që të rritet dhe të zhvillohet brenda saj,” shkruan autori i famshëm gjerman, Anselm Grün.

Nga kjo thënie kuptojmë se pema e jetës, qoftë ajo e një njeriu, e një familjeje, e një kombi, e një kulture e një tradite, ka nevojë për rrënjët e veta që të rritet e zhvillohet brenda saj, përndryshe është e destinuar të vdesë. Ne nuk duam dhe nuk do të lejojmë që kjo të ndodhë, sepse ruajtjen dhe kultivimin e rrënjëve tona e kemi amanet nga jeta, fjala dhe gjaku i derdhur i të parëve tanë.

Tani me dëshirën për të përcjellë një mesazh për ju të dashur të pranishëm dhe për ata që na ndjekin përmes rrjeteve sociale, dua të ndalem shkurtimisht në tre karakteristika themelore të rrënjëve.

1. Rrënjët tona na bashkojnë dhe na mbajnë të bashkuar

Me fjalën rrënjë nënkuptojmë simbolikisht ato elemente të thella dhe themelore që përbëjnë identitetin e një kombi. Rrënjët e një kombi janë ato që e bëjnë atë të veçantë, pra unik dhe koherent me kalimin e kohës, pa prishur harmoninë dhe integritetin me kombet dhe kulturat e tjera.

Rrënjët që e mbajnë të bashkuar një komb

janë historia dhe tradita që e ka formuar atë, duke i dhënë atij një trup, një identitet dhe një qytetërim.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm i rrënjëve të një kombi është gjuha si mjet komunikimi që bashkon njerëzit. Prandaj ne duhet ta ruajmë gjuhën shqipe në ambientet tona familjare, kulturore dhe fetare, sepse pa të nuk do të mund të transmetojmë kulturën, vlerat dhe njohuritë nga një brez në tjetrin, pa gjuhën do të jetë e vështirë dhe pothuajse e pamundur të ruhen traditat tona.

Një element tjetër integral i rrënjëve të një populli është feja dhe vlerat shpirtërore. Në këtë fushë, ne shqiptarët, për shkak të faktorëve historikë tashmë të njohur, ndahemi kryesisht në të krishterë dhe myslimanë.

Në takimin e javës së kaluar mes priftërinjve të Kishës Katolike që shërbejmë në Zvicër dhe disa hoxhallarëve, që u zhvillua në Zürich, nën patronatin e konsullit të nderuar z. Vigan Berishës, në fjalimin e mbajtur, mes të tjerave theksova: “Shumë të nderuar, ne e dimë se pikëpamjet tona fetare janë të ndryshme, madje mbi disa tema shumë të ndryshme, po ashtu edhe mbi teologjinë, doktrinën dhe moralin, megjithatë kemi edhe të përbashkëta sepse fetë tona janë monoteiste, pra ruajnë besimin në një Zot të vetëm. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të komunikojmë dhe të debatojmë duke ruajtur respektin e ndërsjellët dhe në këtë mënyrë të ndihmojmë popullin, veçanërisht ata persona që janë në kërkim të një identiteti shpirtëror, të vendosin me vetëdije, më liri dhe me përgjegjësi se cilën fe, cilën doktrinë dhe çfarë disipline etike dhe morale dëshirojnë të ndjekin, të besojnë dhe kështu pastaj t’ua kalojnë brezave të rinj. Por kjo ndryshueshmëri apo ky dallim që ekziston në pikëpamjet tona fetare nuk duhet të jetë i tillë përballë identitetit tonë kombëtar, sepse historia, tradita, kultura, figurat tona kombëtare janë të përbashkëta dhe duhet të mbeten gjithmonë të tilla, këto nuk mund të cenohen e as të shtrembërohen, aq më pak të fyhen sipas tekeve të caktuara apo interesave personale, fetare dhe politike. Nëse nuk e pranojmë, vlerësojmë dhe promovojmë këtë trashëgimi historike dhe kulturore ashtu sikurse ajo është në të vërtetë,

atëherë komunikimi konstruktiv do të bëhet i pamundur, uniteti ynë do të dobësohet dhe vizioni për të qenë pjesë e pandashme e familjes së madhe evropiane do të pengohet, dhe kështu do të mbetemi peng të vetvetes.»

2. Rrënjët tona na frymëzojnë

Një karakteristikë tjetër e rrënjëve kulturore është frymëzimi që jep jetë dhe mban në jetë. Rrënjët dhe trashëgimia kulturore duhet të jenë burim krijimtarie, shprehjeje dhe risie për një popull pa humbur origjinalitetin dhe identitetin. Kur një popull e lë veten të frymëzohet nga rrënjët e tij kulturore, atëherë ato rrënjë do të marrin formë duke gjetur shprehje konkrete në muzikë, vallëzim, poezi, art, letërsi, aktrim dhe gatim, sinteza e të cilave është kjo mbrëmje festive, e cila shpalos përpara nesh këto vlera dhe tradita të përbashkëta. Nga sa themi kuptojmë më mirë se rrënjët tona kulturore nuk janë dhe nuk mund të jenë pengesë për zhvillimin apo integrimin, përkundrazi, ato janë pikënisja pa të cilën nuk do të dimë se ku jemi dhe ku duam të shkojmë.

3. Rrënjët tona na tregojnë rrugën që duhet ndjekur

Në shprehjen: Gjurmëve të rrënjëve tona, ndeshemi me ftesën e shenjtë që na bëjnë të parët tanë për të ndjekur gjurmët e tyre dhe kështu të jetojmë me mençuri të tashmen, duke u orientuar drejt së ardhmes perëndimore që na kanë trashëguar të parët tanë.

Shkrimtari ynë i madh Kadare, i vlerësuar nga më të mëdhenjtë e qytetërimit botëror si rojtari i së bukurës dhe lirisë njerëzore, sikur përmbledh të gjithë trashëgiminë tonë kulturore e shpirtërore, duke ftuar këdo që ndihet vërtetë shqiptar të jetë flamurtari i identitetit të tij evropian.

Në këtë kuptim, rrënjët tona kulturore mund të shihen si një busull që drejton rrugën tonë, duke treguar një rrugë të bazuar në vlera, tradita dhe përvoja që formojnë një qytetërim të jetës, lirisë dhe dashurisë.

(Ky është fjalimi i plotë i Dr. Don Anton Ukës mbajtur më 23 nëntor 2024 në Emmenbrücke në mbrëmjen kulturore «Gjurmëve të rrënjëve tona»)



POROSITË E NËNË TEREZËS PËR NJERËZIMIN

Në përvjetorin e 45-të të nderimit të Shën Nënë Terezës me Çmimin Nobel për Paqe, Don Lush Gjergji sjell edhe një veprë të re, (ka botuar 19 vepra kushtuar Shën Nënë Terezës) që pasqyron thellësisht jetën dhe mesazhin frymëzues të Nënë Terezës për paqen dhe dashurinë. Duke u bazuar në përvojat dhe përkushtimin e saj të palodhshëm për të varfërit, ky libër ndihmon të kuptohet më thellë fryma e saj e dashurisë dhe mesazhi hyjnor që ajo përçoi në të gjithë botën. Në këtë libër autori jetën dhe veprën e Shën Nënë Terezës e ndan në tri faza me tri emërtime: Gonxhe Bojaxhiu (1910 – 1928), Motra Tereze e Loretos (1929 – 1950), dhe Nëna Tereze – Misionare e Dashurisë (1950 – 1997).

“Me gjak jam shqiptare. Me nënshtetësi indiane. Me besim jam një murgeshë katolike. Sipas thirrjes time, i përkas botës mbarë. Por sa i përket zemrës sime, ajo i përket tërësisht Zemrës së Jezusit.”

Jeta dhe veprat e Shën Nënë Terezës janë përplot me mesazhe të ndritshme dhe thirrje për përkushtim ndaj të tjerëve, veçanërisht ndaj më të varfërve, të sëmurëve dhe të braktisurve. Në librin “Porositë e Shën Nënë Tere-

zës për ne”, Don Lush Gjergji afron më pranë një figure që kapërcen kohën dhe hapësirën, duke ofruar jo vetëm mësim për jetën, por edhe një shembull të gjallë të besimit dhe sakrificës. Nëpërmjet këtij libri, mësohet se çdo fjalë e Nënë Terezës buron nga një përjetim i thellë shpirtëror dhe nga një lidhje e pandashme me Jezusin dhe Zotin. Përmes thënieve të saj, ajo nuk na ofron vetëm fjalë, por një rrugë drejt një jete të plotë, të ndritur dhe të mbushur me dashuri.

Një mesazh i ndritshëm nga errësira e botës: “Vepra të vogla me dashuri të madhe.”

Në rrugëtimin e saj të gjatë dhe të vështirë, Nënë Tereza përjetoj një dashuri që mban-te brenda dritën e shpresës dhe të mëshirës. Në libër, Don Lush Gjergji mëson se mesazhet e saj nuk ishin thjesht këshilla; ato ishin fryt i përjetimeve të saj të përditshme, të dashurisë se saj ndaj Jezu Krishtit, të ndërtuara mbi vuajtje dhe shërbim të përvuajtur. Në çdo fjalë dhe çdo thënie, ajo përiqej të na kujtonte se, përtej errësirës së përditshme, gjithmonë ekziston një dritë që na udhëheq dhe që drita është përlësia dhe dashuria ndaj tjetrit.

Afërsia e Shën Nënë Terezës me Zotin si burim i misionit të saj

Libri bën të reflektohet mbi afërsinë që Shën Nënë Tereza kishte me Jezu Krishtin, një marrëdhënie që ajo e përjetonte si një dashuri të gjallë dhe të përhershme, pavarësisht vuajtjeve. Në thëniet e saj gjejmë një rrëfim të thellë për Zotin dhe Jezu Krishtin si burimin e gjithçkaje që ajo bënte; ishte kjo lidhje e pandashme që e forcoi atë të duronte dhe të shërbente, edhe kur vetë ndiente boshllëk dhe dhimbje të thellë.

Mësime për të sotmen, si të ndjekim shembullin e saj.

Me gjuhën e thjeshtë dhe prekëse, Don Lush Gjergji sjell një qasje të rëndësishme mbi atë që mesazhet e Nënë Terezës mund të nënkuptojnë për shoqërinë moderne. Në një botë të mbushur me sfida dhe ndarje, fjalët e saj bëhen thirrje për reflektim dhe veprim. Ky libër fton jo vetëm ta kujtojmë Shën Nënë Terezën, por dëshiron të nxisë të jetohet sipas shembullit të saj, duke kultivuar dashurinë, durimin dhe mëshirën në jetën tonë të përditshme. Nënë Tereza thotë: “Të duash do të thotë të bësh gjëra të vogla me dashuri të madhe.”

Dashuria dhe shpresa: Jezusi si qendra e gjithësisë hyjnore për Shën Nënë Terezën

Shën Nënë Tereza përjetoj dashurinë për njerëzimin përmes një përkushtimi të plotë ndaj Jezusit, i cili për të përfaqësonte gjithçka që përmban gjithësia hyjnore. Jezusi ishte burimi i palodhur i dashurisë, përlësisë dhe shpresës në zemrën e saj. Në librin e Don Lush Gjergjit, kuptohet se kjo lidhje ishte aq e thellë, sa gjithçka që ajo bënte, çdo gjest dashurie dhe sakrificë ndaj të varfërve, ishte një mënyrë për të afruar Zotin tek njerëzit. Për Shën Nënë Terezën, shërbimi i përkushtuar ndaj njerëzimit ishte një reflektim i dashurisë dhe mëshirës së Jezusit.

Frymëzimi për botën përmes afërsisë me Zotin

Mesazhi që përçon ky libër është që përmes afërsisë me Zotin, njeriu mund të kapërcejë vështirësitë dhe ta shndërrojë dhimbjen në dashuri dhe shpresë. Don Lush Gjergji thekson se për Shën

Nënë Terezën, çdo gjest i vogël i mëshirës ishte një akt madhor, sepse vinte nga një burim hyjnor. Jezusi për të ishte drita që i jepte kuptim çdo sakrificë dhe që e mbante të fortë në misionin e saj, duke u bërë kështu shembull për të gjithë ata që kërkojnë të ndërtojnë një botë më të mirë përmes dashurisë dhe besimit. Në çdo gjest, ajo reflektonte idealet e përlësisë, dashurisë ndaj të tjerëve dhe të shërbimit.

Një mesazh i përjetshëm i dashurisë dhe përlësisë

Ky libër na fton të ndjekim këtë shembull të shenjtë, për të ndërtuar një botë më të ndritur përmes dashurisë dhe përkushtimit ndaj tjetrit. Duke u mbështetur në burimet e besimit, autori tregon se ndjekja e shembullit të Shën Nënë Terezës është rruga që na afron më pranë dashurisë hyjnore. Ashtu sikurse ajo e shihte Jezusin si gjithçka në jetën e saj, edhe ne jemi të thirrur të ndjekim këtë dashuri përlësie dhe shprese për njerëzimin.

Thirrje për veprim dhe përkushtim të përjetshëm

Libri i Don Lush Gjergjit, ‘Porositë e Shën Nënë Terezës për ne,’ nuk është vetëm një përmbledhje e thënieve të një figure të madhe, por një thirrje e gjallë për të ri zgjuar dashurinë, përkushtimin dhe shpresën në jetën tonë të përditshme. Shën Nënë Tereza na kujton se secili prej nesh ka mundësinë dhe përgjegjësinë për të sjellë dritë në errësirën e botës përmes një akti të thjeshtë dhe të përlulur dashurie ndaj tjetrit. Kjo është jo vetëm një udhëheqje shpirtërore, por një ftesë për veprim të përditshëm.

Me këtë frymë, ky libër na bën të reflektojmë jo vetëm mbi jetën e saj, por mbi rolin që kemi për të ndjekur shembullin e saj. Dashuria dhe shpresa që ajo mishëroi vazhdojnë të ndriçojnë rrugën tonë dhe të na kujtojnë se në çdo gjest të vogël dashurie, është i pranishëm vetë Zoti. Kështu, nëse ndjekim këto mësim, do të sjellim një pjesë të dritës së Nënë Terezës në botë dhe do të mbetemi të përkushtuar ndaj thirrjes së saj për më shumë dashuri dhe përlësi.

Shkruan: Bardhec Berisha – Bardhi, Neudorf



Foto: Martin Musaj

Edija që aktivitet në Zvicër ishin në një dimension tjetër dhe këtë mundësi e kisha edhe ta shijoj gjatë ditëve që kalova mes bashkatdhetarëve tanë në Luzern.

«Gjurmëve të rrënjëve tona», thellësisht motivi dhe përpikëria nis prej këtu. Gjurmët, rrënja dhe shqiptarët dalin të jenë realiteti mes mallit dhe atdhedashurisë, asaj që i përket realitetit dhe diçkaje të paluajtshme.

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern dhe Shoqata Humanitare «Nënë Tereza» arritën që idenë e tyre krijuese dhe ndjesinë e atdhedas-

hurisë ta lidhin mes nesh. Nuk u dëgjua vetëm për Shën Jeronimin e Shën Nënë Terezën, u dëgjua e u ndje edhe më shumë se kaq. Realisht nëpërmjet këtyre dy figurave kemi faktin e zgjedhur të dashurisë, guximit, familjes, jetës dhe për t'u thënë dëshmi smjaftojnë minuta as orë. Të zgjedhurit e njerëzve plot vlerë përballë masës së pranishmëve të mrekullueshëm i dha jehonë e vlerë këtij manifestimi, përtej aspektit kulturor. Nuk ishte vetëm zjarri i atij momentit të daljes në skenë në rolin e prezantueses përballë njerëzve, ishte edhe mënyra sesi prisnin të thuheshin fjalët, mënyra se si duartrokisnin, mënyra sesi prisnin me admirim secilën paraqitje. Dashtë Zoti që shqiptarët kudo në botë të jenë misionar të dashurisë dhe lidhjes me njëri-tjetrin.

Ky Mision dhe kjo Shoqatë na vërtetuan me dëshmi se kultura jonë shqiptare përcillet denjësisht nëpër gjenerata pavarësisht ku ndodhemi. U dëshmuua përmes flakërimit emocional të valltarëve të veshur me veshjet tradicionale dhe jo vetëm në mbrëmjen e së shtunës por edhe të nesërmen gjatë meshës shenjtë në Emmenbrücke. Apero pas aktivitetit ishte një tjetër moment kënaqësie kur nga ajo që kishin përgatitur pa



Foto: Martin Musaj

thënë fjalë shfaqte delikatese - dashuri. Njohja e shqiptarëve me njëri- tjetrin, të bërit gëzuar dhe të lëvduarit e Krishtit mes atij bollëku jep domethënien e të vlerësuarit dhe respektit për të gjithë atë që u zhvillua dhe gjithë asaj që Zoti ka bërë të mundur të jetojmë.

Meqë aktivitete të një pas njëshme pasuan po përmend edhe Meshën kur ritet fetare u përcollën ngrohtësisht me ato tradicionale. Uratë e lutje në gjuhën më të bukur të botës, këngë shqip dedikuar shenjtëreshës Nënë Tereza, Kosovës e Shqipërisë.

Unë personalisht jam shumë falënderuese ndaj Zotit dhe organizatorëve për këtë mundësi kaq unike. Ngelet ne mua si një nga aktivitetet më të organizuara dhe në thelb me më shumë dashuri.

Zoti i bekoftë shqiptarët kudo ndodhen, bota u krenoftë me ne , e ne më së me njëri-tjetrin.

Shkruan: Jehona D. Gashi, Doberdol, Klinë.



(Foto: Martin Musaj)



(Foto: Nue Tuqi)

Mbledhje me Këshillin e Misionit

Më 7 dhjetor 2024, në orën 20.00, Këshilli i Misionit u mbledh në mbledhjen e zakonshme, të fundit të këtij viti.

Pas leximit dhe nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar, u prezantuan dhe diskutuan temat e planifikuara për këtë mbledhje.

Fillimisht u prezantua agjenda e vitit 2025 me të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm. Më pas u diskutua gjerësisht për krenimin e Krishtlindjeve dhe bekimin e familjeve që do të nisë në fillim të vitit 2025. Po ashtu u paraqit edhe ecuria e punës dhe përpjekjeve tona me Kishën lokale për të marrë qendrën e re dhe Kishën në Emmen LU. Një tjetër pikë diskutimi ishte Jubileu 2025, Viti i Shenjtë dhe shtegtimitet tona të planifikuara në Romë. Si zakonisht, në fund të takimit përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të Misionit prezantuan dinamikën e aktiviteteve të tyre. Qëllimi i takimeve dhe punës sonë është që Misioni ynë të jetë sa më funksional dhe në shërbim të të gjithëve.

Shkruan: Redaksia



(Foto: m. Mrika Sabedini)



LUMNIMI I ÁT LUIGJ PALAJT DHE I DOM GJON GAZULLIT

(Foto: R.V.)

Më 16 nëntor, në orën 10.00, në katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër, është kremtuar mesha për lumturimin e dy meshtarëve, njëri françeskan e tjetri dioqezan. I dërguari i Papës për këtë kremtim ishte prefekti i Dikasterit të Vatikanit për Çështjet e Shenjtorëve, kardinali Marcello Semeraro, që ka kryesuar meshën solemne dhe ritin e lumturimit si dhe homelinë e rastit

Kisha Katolike në Shqipëri ishte në festë për lumturimin e Át Luigj Palajt (Paliq) dhe të Dom Gjon Gazullit. Ishin të pranishëm ipe-shkvijtë e Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Italisë, si edhe autoritete civile e fetare. Një prani e veçantë ishte ajo e kardinalit shqiptar Ernest Troshani Simoni.

Dekretet e Selisë së Shenjtë

Pas 38 martirëve të epokës së komunizmit, që u shpallën të Lumë në vitin 2016, me Át Luigj Palajn e Dom Gjon Gazullin numri i martirëve të lumë bëhet 40. Kujtojmë se Selia e Shenjtë e shpalli dekretin e lumturimit më 20 qershor 2024.

Át Luigj Palaj është personifikimi më i qartë i persekutimit të katolikëve shqiptarë të Koso-

vës. Në vitin 1913, ndërsa në Kosovë dhe më konkretisht në Gjakovë, vazhdonte fushata e egër e persekutimit dhe e asimilimit të katolikëve shqiptarë, Át Palaj i inkurajonte besimtarët e asaj treve të mos hiqnin dorë nga feja e të parëve dhe nga identiteti shqiptar. Për këtë arsye, për shkak të një urrejtjeje patologjike ndaj çdo gjëje katolike dhe shqiptare, pushtuesit malazezë e arrestuan dhe e torturuan në mënyrë çnjerëzore. Pas një periudhe të gjatë burgosjeje në Gjakovë, ku edhe pse nën tortura të tmerrshme nuk e pranoi ndërrimin dhe mohimin e fesë, ai u tërhoq zvarrë nëpër rrugë dhe u shporua me bajoneta në Pejë, duke ndërruar kështu jetë.

Martiri tjetër, dom Gjon Gazulli, nga fisi i njohur i Gazullorëve, u ekzekutua nga mbreti Zog me varje, në Shkodër, më 5 mars të vitit 1927. Ai ishte kundërshtar i tij, për shkak të politikave shpeshherë diskriminuese për zonat katolike, sidomos për Dukagjinin. Gjithashtu, kundërshtoi ashpër dhe hapur të ashtuquajturin “bashkim personal të Shqipërisë me Jugosllavinë” më 2 janar 1927.

(Marrë nga Radio Vatikani)

MOMENTET E FUNDIT TË JETËS SË DOM GJON GAZULLIT

“Ishte ora 11 para mesnate. Udhët e Shkodrës ishin endë të rrahuna prej njerëzish, pse ishte Bajram. Dhash urdhën të thirrej famullitari Gàzulli n’oborr, pse donte me folë me të lpushkvi. Gazulli zbriti poshtë. E kuptoj çfarë do të ndodhte.

Një françeskan me Sakramend ndej para tij At Martin Gjoka, Françeskani kishte mbetë pa gojë. Famullitarit Gàzulli nuk i ndrroi aspak ngjyra e fytyrës... Ai i kapi dorën Atit e i tha: “Pater Martin, tash ke me më Rrëfyje”. Ati iu lut ushtarëve të mbledhun për rreth me u largue. Mbas na nuk u larguem, Ati i tha: – “Dom Gjon, Rrëfeju, pra, latinisht a italisht”. – “Jo, Pater, i përgjegjet Gàzulli, të mbramin Rrëfim due me e ba në gjuhë të Nanës”. E kështu Ai u rrëfyje në sy tanë. Na, Muhamedanët, pak marrim vesht kësi sendesh, por mëkat nuk dëgjuem prej gojës së tij. Mandej i dha Ati një bukë të hollë, të bardhë, e rrumbullakët, që e kapërdini me një përshpirtni të madhe. Ai u dukte se po shndritte krejt fytyret.

Tash u çil dera e burgut, e u nisëm. Ushtarët ishin para, mbrapa e në të dy anët, ma shumë se kurrë. Në mjedis ishte Ai dhe Ati. Gjithë udhën u luten të dy me za të naltë, por unë muejta me vu ore se zani i Atit dridhej, nësa zani i famullitarit tingëllonte i qetë e i qartë. Një trimni kaq të madhe kurrë s’e pash në jetë time.

Kishim arrijtë te vendi i vdekjes, në Fushë të Druve. Aty ishte shtylla e vdekjes.

Magjypi ishte gati me litar në dorë. Një dritë elektrike e shndritte thektas famullitarin në fytyrë. Ai nuk dridhej aspak. Edhe mue më kishte kapë frika. Mue më ishte dashtë me përcjellë edhe të tjerë te ky vend i mjerë, por tash ishte tjetër. Unë kisha gati si një frikë para qetësisë së këtij Prifti. Ai ishte me të këputme i pafaj. Këte e dijsim të gjithë. Por, urdhni! Unë, sikur asht zakoni, i lash fjalën e lirë. Por ma mirë mos ta

kisha ba këtë gja! Ai nisi me folë me një za aq të fortë, e me fjalë të drejta e që të këputshin zemrën, sa që mue përnjimend më kapi frika. E ta kisha lanë me shkue gjatë me fjalë, kishte muejtë të gjithëve me na ba me u kthye prej vetit. Mue më duhej me mendue për përgjegjësinë teme. E i thash shkurt: Zotni, s’duem me ndje predke! Foli fjalët e mbrame. Mjaft!

Atëherë Ai çoi zanin edhe ma e tha: Vetë po vdes i pafaj. Rroftë Krishti, Mbreti ynë! Rrënoftë Shqipnia dhe Shqiptarët e vërtetë”.

Na ishim të gjithë të përmalluem fort. Lexova vendimin e dekës. I qe veshë një këmishë e bardhë. Magjypi ia vuni vjercën e konopit në fytyrë e i hoq shkambin nën kambë. Ishte dita e 5 marsit 1927”.

(Ekzekutimin e tij e përshkruan në një intervistë në revistën gjermane “Korrespondenz des Priestergebetsve”, oficeri i ngarkuar me varjen e dom Gjonit, Xhemal Dibra).



(Foto: R.V.)



(Foto: Kastriot Frokej)

Der Nikolaustag, der in der Schweiz auch als Samichlaus bekannt ist, wird jedes Jahr am 6. Dezember gefeiert und blickt auf eine lange Tradition zurück. Seine Ursprünge liegen in der historischen Figur des heiligen Nikolaus von Myra. Die Legenden und das Vermächtnis dieses Bischofs aus dem 4. Jahrhundert prägen bis heute Bräuche und Rituale in vielen Ländern. Nikolaus ist dabei ein Symbol für Grosszügigkeit, Mitgefühl und Bescheidenheit und eine zentrale Figur in der christlichen sowie volkstümlichen Kultur.

Das Leben und Wirken des heiligen Nikolaus

Nikolaus von Myra lebte in der Region der heutigen Türkei und wurde vor allem durch seine Nächstenliebe bekannt. Eine der bekanntesten Geschichten erzählt, wie er drei jungen Frauen heimlich Goldmünzen schenkte, um sie vor Armut und einem Leben in Not zu bewahren. Aus dieser Legende entwickelte sich die Tradition, kleine Geschenke in Stiefel oder Strümpfe zu legen.

Der heilige Nikolaus steht bis heute für Hilfsbereitschaft und Mitgefühl. Seine Taten zeigen, wie wichtig Nächstenliebe ist, und ma-

chen ihn zu einem Vorbild für Christen. Sein Leben war geprägt von der Hingabe an andere, was ihn zu einer bedeutenden religiösen Figur macht.

Vom Nikolaus zum Weihnachtsmann

In der modernen Kultur hat der Nikolaus eine interessante Entwicklung durchlaufen. Während er in religiösen Traditionen eine heilige Figur bleibt, wurde er in westlichen Ländern zum Vorbild für den Weihnachtsmann. Dieser repräsentiert heute jedoch oft die kommerzielle Seite des Schenkens.

Traditionen rund um den Nikolaus

In vielen katholischen Regionen ist es Brauch, dass der Nikolaus in Begleitung eines Engels oder einer Figur wie Knecht Ruprecht die Häuser besucht. Der verkleidete Nikolaus liest aus einem goldenen Buch vor, in dem die guten und schlechten Taten der Kinder verzeichnet sind, und verteilt Geschenke. Knecht Ruprecht, der auch als Schmutzli bekannt ist, übernimmt in einigen Regionen die Rolle des mahnenden Begleiters. Diese Tradition, die im Mittelalter entstand, diente ursprünglich der Erziehung.

In vielen Städten und Dörfern wird der Nikolaustag mit feierlichen Umzügen gefeiert. Dabei spielen oft traditionelle Elemente wie das Geisselklöpfen und Trychlen eine wichtige Rolle. Das laute Knallen der Geisseln und das rhythmische Läuten der grossen Kuhglocken verleihen dem Umzug eine besondere Atmosphäre und symbolisieren das Vertreiben von bösen Geistern. In der Schweiz geniesst dieser Tag einen hohen Stellenwert. Auch in der albanischen Tradition wird der Nikolaustag gefeiert, jedoch bereits am Abend des 5. Dezember. Familien versammeln sich zu einem festlichen Essen, das oft durch besondere Gerichte hervorgehoben wird. Diese Tradition unterstreicht die Bedeutung von Gemeinschaft, Dankbarkeit und Zusammenhalt. Der Nikolaustag wird dabei nicht nur als festlicher Anlass, sondern auch als Moment der Besinnung auf Nächstenliebe und Grosszügigkeit begangen – Werte, die eng mit der Figur des heiligen Nikolaus verknüpft sind.

Shkruan: Bergita Krasniqi, Luzern



(Foto: Kastriot Frrokaj)

Aktivitet bamirësie

Më 11 dhjetor, qendrës sonë në Luzern iu bashkuan mbi 40 gra dhe vajza të reja, të cilat sollën me vete lloje të ndryshme biskotash të Krishtlindjeve të gatuar me shumë dashuri dhe profesionalizëm dhe të gjitha së bashku në një atmosferë gëzimi i përgatitën për shitje dhe paratë e mbledhura do të shkojnë për ata njerëz që kanë nevojë për ndihmën tonë. Përveç grave të pranishme kishte edhe nga ato që për shkak të punës nuk mundën të ishin të pranishme, por paraprakisht dërguan pako me biskota.

Disa prej tyre, përveç paketimit të biskotave të përgatitura, u kujdesën edhe për darkën e përbashkët. Kështu pasi mbaruan përgatitjen e biskotave, hëngrën darkë dhe kaluan një mbrëmje shumë të bukur dhe të lumtur së bashku.

Falënderojmë Zotin dhe të gjithë ata njerëz që janë gjithmonë të gatshëm të na ndihmojnë në aktivitetet tona.

Shkruan: Redaksia



(Foto: Valentina Prenrecaj)



(Foto: Vjollca Bisaku)



(Foto: Firok Kola)

“**J**u nuk mund ta kuptoni dot se ç’do të thotë qytet i lirë, sepse ju rriteni në robëri», shkruan Ismail Kadare në romanin “Kronikë në gur”, ku flet për Luftën e Dytë Botërore, të parë nga sytë e një të riu, në Gjirokastrë, qytetin me të çuditshmi në tokë, ku kryqëzoheshin histori e kultura e ku qyteti përherë ishte “nën sundimin e ri.”

Ai lindi më 28 janar 1936, pranë oxhakut, në një kohë kur botën e kishin kapluar shtrëngata e ideologji. Si djalë i ri, vëzhgonte çështjet e marrëzisë në familjet gjirokastrite, në një qytetit të çuditshëm, ku “ishte vështirë të ishte fëmijë.” Ishte fëmijë kur magjepsej nga bota e letërsisë dhe që atëherë ëndërronte të bëhej shkrimtar i madh, por nuk i pël-



(Foto: Martin Musaj)

qente emri Ismail. Mbiemrin Kadare e quante klas, sepse i shkante një shkrimtari të madh, ndaj donte ta ndërronte e ta bënte Ismail Hello Kadare, për t'iu ngjarë të mëdhenjve, si Honore de Balzak. Djaloshi që rritej nën hijen e kështjellës së vjetër, në një qytet plot thas-hetheme, gjyqe, shtëpi me burgje brenda, gra që ngujoheshin e nuk dilnin kurrë jashtë, në një qytet që ngjante në një teatër, në moshë të re e ndien një thirrje të brendshme, për t'iu përkushtuar letërsisë, një thirrje që ishte krejt e pazakontë, tunduese, e mistershme, diçka që dukej sikur u përkiste forcave të epërme. “Unë i besova kësaj magjepsje, ashtu siç i besohet një feje”, thotë Kadare. Me këtë besim, ai hyri në portat e letërsisë, i magjepsur nga “Makbethit” i Shekspirit dhe letërsia u kthye në dashurinë më të madhe të jetës së që nuk u shua derisa ishte gjallë mbi tokë. Kur ai hyri në botën e artit, e keqja komuniste kishte pllakosë mbi jetën shqiptare. Përballë kësaj gjendje, përmes gjuhës, thelbit të ekzistencës njerëzore, ai iu kundërvu së keqes, duke krijuar një univers letrar e estetik mahnitës, plot dhimbje njerëzore, mistere, ku kryqëzohen udhë e kultura, kohë e epoka, ku duken plasaritje të thella të tokës e çarje të lartësive qiellore, një botë përplot çudira, moskuptime, kuptime të shumëfishta e mistere të përherëshme, siç është vërtet bota njerëzore. Në një Shqipëri të izoluar e nën thundrën e një regjimi despotik, përmes gjenialitetit krijues ai e afirmoi të bukurën e mirëfilltë, duke u kthyer në njëllor rojtari të saj. Shqipëria komuniste i luftonte vlerat perëndimore, traditën, lirinë e personit e dashurinë njerëzore, e Kadareja këto tema i kthehu në art, duke hapë alternativa të reja të kuptimit të ekzistencës njerëzore, jashtë kornizave ideologjike, përmes humorit, alegorisë, simboleve e gjuhës artistike.

Sundimi komunist me kërbaç donte që njerëzit t'i binde në shenjtërinë politike të udhëheqësit e të regjimit të tij, kurse Kadareja refuzoi të shkruante për lavdinë e kërbaçit e për “lumturinë komuniste”, por lexuesit

i orientoi tjetërkah, duke shpërfaqë forcën e pushteteve despotike, përmes evokimit të ngjarjeve historike e ligjëritit alegorik. Regjimi i Hoxhës, kulturën perëndimore e kishte shpallë armiqësore, e Kadareja pikërisht këtë kulturë, me inteligjencë të jashtëzakonshme, e ktheu në epiqendër të veprës së tij, përmes kujtimit të Shqipërisë historike, mesjetare, kohës së Gjergj Kastriotit, mitologjisë, Biblës.

Pikërisht kjo është arsyeja pse në veprën e tij, figura e Gjergj Kastriotit zë vend esencial, ngaqë amshueshmëria e tij ka vullosë diçka të shenjtë në historinë shqiptare. Skënderbeu e përshkon veprën e Kadaresë si frymë, ide e shpirt, në funksion të ndarjes mes lirisë dhe robërisë. Në këtë aspekt, identiteti i letërsisë së Kadaresë, si tematikë dhe filozofi, është rrjedhim i idesë që përfaqëson Skënderbeu. Kadare është shkrimtari i madh, rojtari i së bukurës e i lirisë njerëzore, flamurtari i identitetit evropian të shqiptarëve e krijues i mirëfilltë i vlerave të amshueshme artistike. Përcjellja nga kjo botë, në një skenë madhështore, nën duart e bashkuara në lutje të Shën Nënë Terezës, sikur e përmbyllte në mënyrën më sublime një mision të shenjtë: po vuloste diçka të pashlyeshme në historinë shqiptare.

Shkruan: Ndue Ukaj, Prishtinë



(Foto: Martin Musaj)



NËNA DHE GJYSHJA

Rritja e një fëmije është misioni më i vështirë që ndërmerret njeriu. Ky mision ka një kusht për t'u realizuar: çdo ndjesi, mendim, fjalë, veprim duhet të udhëhiqet nga përgjegjësia. Edhe dashuria vetë duhet të dhurohet nëpërmjet saj.

Natyra e ka zgjidhur shumë bukur; pranë nënës së re, në kulm të instinktit të saj mëmësor, qëndron nëna e pjekur (gjyshja) me përvojën e saj dhe pjekurinë psikoemocionale. Gjyshja përbën një figurë të rëndësishme në jetën e njeriut.

Kjo “dyshe” ideale, në harmoni me nënën e re, ndihmon në rritjen e përsosur të fëmijës. Energjia në shpërthim e nënës dhe pjekuria e gjyshes realizojnë të “përkryerën femërore” për të rritur fëmijën e shëndetshëm, si fizikisht ashtu edhe psiko-emocionalisht. Kjo formë është e shëndetshme, përsa kohë, secili nuk ngatërron pozicionin dhe rolin përkatës.

Roli i gjyshes është i pazëvendësueshëm, por jo i domosdoshëm si ai i nënës.

Gjyshja ka fituar aftësinë e vetkontrollit dhe përgjedh shumë mirë veprimin dhe fjalën e saj.

Gjyshja komunikon me mbesën/nipin, duke fuqizuar figurën e nënës, sidomos kur ajo nuk është e pranishme. Ajo duhet t'i afrohet fëmijës gjithmonë nëpërmjet nënës dhe duke ruajtur figurën e saj. Gjyshja nuk mund ta zëvendësojë nënën.

Megjithatë është personi më i përshtatshëm për të qëndruar me fëmijën në mungesë të saj. Rëndësi të veçantë gjyshja merr në disa situata të caktuara.

Ajo duhet të asistojë nënën e re, veçanërisht në ditët dhe javët e para të jetës së fëmijës me qetësinë, inkurajimin dhe vetkontrollin e saj, duke e siguruar nënën e re, se shumë shpejt ajo do t'ia dalë mbanë. Ajo siguron prindërit e rinj se është vetëm çështje kohe, ata janë duke ndërtuar një rutinë të re në mënyrën e të sjellurit dhe të menduarit. Tashmë janë tre.

Natyrshëm, nëna kryen çdo veprim e udhëhequr nga instinkti mëmësor dhe në favor të fëmijës së saj. Ndërsa gjyshja, realizon një veprim që nuk e ka kryer më parë tek fëmija i saj, pra ajo plotëson diçka për veten. Nëna kryen veprimet për fëmijën e saj, ndërsa gjyshja plotëson veten. Pavarësisht nga cilësia e mëmësisë, nëna i jep fëmijës, ndërsa gjyshja merr nga fëmija. Mjaft të risjellim ndërmend shprehjet: “Më kënaq”, “Më shlodhi”.

Nëse duam të veprojmë në të mirë të fëmijës, duhet të kontrollojmë veten dhe të lejojmë nënën t'i kryejë veprimet ndaj fëmijës së saj. Çdo veprim i kryer nga të tjerët dhe që përjashton nënën, përkatëhet si vuajtje për fëmijën.

Shkruan: Lira Gjika, Tiranë



DHUNA RRËNJOS TË KEQEN DHE ÇRRËNJOS TË MIRËN

(Foto: pixabay.com)

Dhuna vret besimin e njeriut te njeriu. Ajo fillon të rrënjohet heshturazi, që në moshën e fëmijërisë, kur njeriu është i vogël e i brishtë në të gjitha dimensionet tij. Ai, i parrituri, nuk mund të bëhet pa sigurinë dhe besimin te i rriturit. Prindërit janë siguria dhe modeli për fëmijën, si duhet të jetë e të silllet kur të rritet. Ata edhe pse e duan shumë fëmijën, kur janë të lodhur nga vetja, jeta apo tjetri, ja transmetojnë këtë gjë fëmijës së tyre, herë pa dashje, e herë për shkak se nuk dinë të sillen ndryshe. Një tjetër formë komunikimi, që injekton dhunën dhe “nënproduktet” e saj, si dyshimi, inatin dhe pasiguria, është, kur partnerët, që harrojnë se janë nënë e baba i fëmijës, hynë në konflikt me njëri tjetrin. Të dy, me prepotencën, që u dikton çasti, harrojnë të kontrollojnë zërin, fjalët e veprimet. Dhe për ta plotësuar kuadrin, të kujtojmë ato shpullat “e vogla”, të shoqëruara me një fytyrë të ngrysur të nënës dhe babait, me një zë të ashpër e urdhërues, në përdorjen e përemrit në vend të emrit. Në neglizhimin se do të vazhdojnë muhabetin dhe fëmija duhet ta tundë e shkundë nënën dhe babain, që ti përgjigjen. Po edhe ato gënjeshttrat, që i thuhet fëmijës, që nëna apo babai të iki ku duhet të shkojë dhe

nuk kanë as kohë e nerva, që të sqarojë fëmijën dhe durojë të qarën e tij, sepse do të rrijë me ta. Të gjitha janë “gjëra të vogla” e pa rëndësi, në pamjen e parë nga ne të rriturit, por fëmija është i vogël dhe këto sjellje janë modeli si duhet të bëhet kur të rritet. Dhe kështu, ato do të rriten me fëmijën duke i shmangur apo tharë, mekanizmat e empatisë, e cila mundëson të mirën dhe njerëzoren. Prindër, “gjërat e vogla” për ne të rriturit, janë shumë të mëdha dhe të rënda, për fëmijën në rritje.

Shkruan: Lira Gjika, Tiranë



(Foto: R.V.)



Duke filluar nga ky prag Krishtlindjesh, Roma, Qyteti i Amshuar, do të hapë portat për rreth 35 milionë shtegtarë, që do të vijnë në kryeqytetin italian për Jubileun e Shpresës 2025. Viti i Shenjtë katolik kremtohet zakonisht një herë në 25 vjet dhe u jep mundësinë besimtarëve të vizitojnë vendet e shenjta, të kryejnë vepra të përsëritshme dhe të kërkojnë faljen e mëkateve. Shtegtarët që vijnë në Romë do të mund të marrin ndjesën e plotë, sipas rregullave të zakonshme të Kishës, që nga 24 dhjetori, dita e hapjes së Portës Shenjte të Bazilikës së Shën Pjetrit.

Jubileu i ardhshëm 2025 pason Vitin e Lutjes 2024, të cilin Papa Françesku e shpalli si periudhë përgatitore për meditimin personal mbi Zotin dhe mbi thirrjen katolike të secilit. Tema e vitit 2025 është “Shtegtarë të Shpresës”, zgjedhur për të nxitur arritjen e paqes në një botë të kërcënuar nga ndryshimet klimatike dhe luftërat e vazhdueshme.

Rruga e shtegtarit

Jubileu është mundësi për Kishën globale që të ripërtërijë impenjimin në favor të kësaj bote të fragmentuar e të shkatërruar nga lufta. Fja-

la “jubile” rrjedh nga hebraishtja “jobel”, bri dashi, që përdorej për të shpallur një periudhë njëvjeçare, në të cilën bujqit i linin arat të palëruara, për të pushuar e për tu shëruar. 1300 vjet pas vitit të parë jubilar katolik, Viti i Shenjtë mbetet një kohë dhe një hapësirë, gjatë së cilës besimtarët mund të mendojnë si të kujdesen më mirë për jetën në Tokë. Në një botë, që ka në qendër produktivitetin dhe individualizmin, Jubileu tregon një mënyrë jetese më të qëndrueshme.

“Shtegtimi është hapësirë ku përforcohet ideja e bashkimit, në mënyrë që kur secili kthehet në shtëpi, të ketë vërtet diçka të re me vete”, pohon Filomeno Lopez, shkrimtar dhe teolog nga Guinea Bissau. “Kjo është veçanërisht e vërtetë për ne afrikanët, sepse e dimë se pjesa më e rëndësishme e jetës është bashkësia”.

Pjesëmarrja në një shtegtim të gjatë dhe të mundimshëm, sipas Filomeno Lopez, ndihmon për të kuptuar përvojën e migrantëve. Vetë Krishti erdhi në Tokë si migrant dhe përvoja njerëzore përbëhet nga udhëtime të përkohshme dhe nga kërkimi i shpëtimit.

(Marrë nga R.V.)

Janar 2025**03.01.2025**

18:30 E premtja e I e muajit,
adhurim dhe Mesha në Luzern

05.01.2025

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Sursee
18:00 Mesha në Giornico TI

06.01.2025

19:00 Dëftimi i Zotit - Mesha në
Luzern

12.01.2025

13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Willisau

19.01.2025

10:30 Mesha në Goldau
13:30 Mesha në Sursee
17:00 Mesha në Stans

26.01.2025

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Emmenbrücke
18:00 Mesha në Menznau

Shkurt 2025**02.02.2025**

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Sursee
18:00 Mesha në Giornico TI

07.02.2025

18:30 E premtja e I e muajit,
adhurim dhe Mesha në Luzern

09.02.2025

13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Willisau

11.02.2025

19:00 Zoja e Lurdit - Mesha me
procesion - Apero në Luzern

16.02.2025

10:30 Mesha në Goldau
13:30 Mesha në Sursee
17:00 Mesha në Stans

22.02.2024

18:00 Festa e pavarisë së Kosovës
në Luzern

23.02.2025

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Emmenbrücke
18:00 Mesha në Menznau

Mars 2025**01.03.2025**

18:00 Mesha në Vetroz

02.03.2025

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Sursee
18:00 Mesha në Giornico TI

05.03.2025

19:30 E Mërkura e Përhime -
Mesha në Luzern

07.03.2025

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha
në Emmenbrücke

09.03.2025

13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Willisau

14.03.2025

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha
në Emmenbrücke

15.03.2025

17:30 Bamirësi: Prerja e flokëve

16.03.2025

10:30 Mesha në Goldau
13:30 Mesha në Sursee
17:00 Mesha në Stans

18.03.2025

09:00 Mesha në Luzern
19:30 e martja e I e Shna Ndout -
Mesha në Emmenbrücke

19.03.2025

09:00 Shën Jozefi - Mesha në
Luzern

21.03.2025

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha në
Emmenbrücke

23.03.2025

11:00 Mesha në Inwil ZG
13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Menznau

25.03.2025

09.03 Mesha në Luzern
19:30 e martja e 2-të e Shna Ndout
- Mesha në Emmenbrücke

28.03.2025

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha
në Emmenbrücke

30.03.2025

13:30 Mesha në Emmenbrücke
Pas Meshës dreka e përbashkët

31.03.2025

18:00 Përgatitja e Pjatave për
Pashkë

**AZB 6005 Luzern
Post CH AG**
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:
Nr. 1/2025
15. März 2025

Erscheint im
März 2025

Impressum

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern
Katholische Albanische Mission in Luzern

Verlag und Redaktion

Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës
Rodteggstrasse 6
CH-6005 Luzern
Tel: +41 41 250 52 60
Cel: +41 79 371 68 91
E-Mail: ukas_cr@hotmail.com
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch

Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.

In memoriam: MONIKA GOJANI **(1992–2024)**

Më 14 nëntor të këtij viti ishte varrimi i të ndjerës së bijës dhe motrës sonë Monika Gojani, e cila para disa dite ndërroi jetë në moshë shumë të re.

Meshën e dritës e kremtoi don Anton Uka, misionar në Luzern, në bashkëkremtim me don Marjan Demaj, misionar në Aarau. Edhe pse ishte rast shumë i dhimbshëm për gjithë familjen, por me besim në Zotin dhe mëshirën e tij dhe me kremtimin e meshës e fjalët ngushëlluese që tha don Antoni, dhimbjen na e bëri më të lehtë. Don Antoni në predikimin e vet është shërbyer me tekstet e Shkrimit shenjtë që vetë Monika duke lexuar Biblën i kishte nënvizuar. Ne shpresojmë dhe besojmë se Monika pushon në paqen e Zotit, sepse gjatë jetës së saj vazhdimisht është përpjekur të mësojë prej fjalës së tij, ta jetojë atë dhe me besim në Zotin është munduar ta bartë kryqin e jetës së vet.

Monika për familjen tonë do te mbetet gjith-

monë ne zemrat tona me të qeshurën e saj, gëzimin, dashurinë dhe humorin e saj të veçantë. Ajo ishte një person që pasuroi jetën tonë familjare, dhe kohët e kaluara se bashku me të. Qoftë në ditëlindje, festa apo takime spontane - ato momente te mbushura me te qeshura dhe ngrohtësi do t'i ruajmë gjithmonë me nderim. Ajo donte të jemi bashkë, dhe ne e vlerësonim praninë e saj po aq shumë. Se bashku kemi qeshur, biseduar dhe krijuar kujtime dhe do të na shoqërojnë përjetë.

Ne do ta duam gjithmonë Molikën, dhe ajo do të ketë një vend të veçantë në zemrat tona. Derisa të takohemi sërish, ajo do të mbetet pjesë e jona, plot dashuri dhe mirënjohje për gjithçka që na ka dhënë.

E dashura bija dhe motra jonë Mënikë, pusho në paqen e Zotit dhe ndërmjetëso për familjen tonë që aq fort e deshe.

Shkruan: Silvana Mataj

Të ndihmojmë Misionin tonë!

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3

Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 | 6005 Luzern



Kath.Albanische Mission
LU

